Mblidhet Asambleja Kombëtare

Shtator 2014, Kongresi i VI I Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë

KALAJA: BSPSH e gatshme për dialog dhe Pakt Social me Qeverinë



"Asgjë e keqe nuk e gjen ekzekutivin shqiptar nëse do të pranojë tavolinën e bisedimeve. Ne jemi të prirur për dialogun, por jemi po aq të vendosur dhe për protestën dhe jemi të zot ta bëjmë atë. Strategjia jonë ka një zgjidhje: arritjen e rezultateve nëpërmjet tavolinës së bisedimeve. Dhe ne e ftojmë publikisht z. Rama të dialogojmë, ashtu siç ai ka deklaruar para dhe gjatë fushatës elektorale se do të merrte kontakt me grupet e interesit në Shqipëri, dhe me organizatat faktorë. Ja ne jemi BSPSH-ja. Ne e kemi hedhur dorezën z. Kryeministër, Ju kemi dërguar platformën tonë ekonomike që pas zgjedhjeve të 23 qershorit dhe ne presim kontaktin me Ju dhe me strukturat tuaja për të marrë në diskutim dhe për të shqyrtuar të gjithë platformën ekonomike që ka paraqitur BSPSH. Ne i bëjmë thirrje të gjitha forcave politike, gjithë faktorit shqiptar, të bëjmë një Pakt Kombëtar me objektiv integrimin sa më shpejt të Shqipërisë në familjen e madhe europiane dhe njëkohësisht bërjen e reformave të cilat do të përmirësojnë jetën e shqiptarëve"

Në mjediset e Hotel “Tirana International” u mblodh më 12 tetor 2013, Asambleja Kombëtare e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë. Asambleja i zhvilloi punimet sipas kësaj procedure: Verifikimi i mandateve të anëtarëve të Asamblesë Kombëtare sipas listës, hapja e mbledhjes dhe prezantimi i rendit të ditës:
Miratimi i strategjisë dhe i politikave që do të ndjekë BSPSH-ja në kuadrin e zbatimit të platformës social-ekonomike paraqitur qeverisë së re dalë nga zgjedhjet e 23 qershorit 2013, referuar nga Presidenti i BSPSH, z. Gëzim Kalaja; Njohja me projekt-vendimin për thirrjen e Kongresit të VI të BSPSH-së, referuar nga Presidenti BSPSH, z. Gëzim Kalaja; Njohja me projekt- programin dhe udhëzimet e zhvillimit të fushatës zgjedhore në strukturat sindikale të BSPSH-së në kuadrin e Kongresit të VI të saj; Njohja me projekt- vendimet mbi shtesat dhe ndryshimet e statutit të BSPSH-së, referuar nga Sekretari Organizativ Koço Jani.
Në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare Presidenti i BSPSH, z. Gëzim Kalaja shpalosi strategjitë dhe politikat që do të ndjekë BSPSH, në kuadrin e zbatimit të programit social-ekonomik.


BASHKIM
TIRANA INTERNATIONAL
2013/10/12 10:03






BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA